



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA PATOS**

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza" Tel: 034 410 663; 034 410 664

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**SPECIALIST URBANIST, SPECIALIST PROJEKTUES**

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 të Keshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin në kategorinë ekzekutive", Bashkia Patos shpall Procedurat e levizjes paralele dhe e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

**katër vende pune** në pozicionin Specialist

2 vende pune si Specialist projektues në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe projekteve

2 vende pune si Specialist Urbanist në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe projekteve

- Kategoria e pagës IV-a.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e levizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së levizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në Shërbimin Civil

**Për të dy Procedurat (levizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LËVIZJE PARALELE**

**20/08/2020**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**25/08/2020**

## • **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist Projektues:**

Studion dhe iu jep zgjidhje problemeve të infrastrukturës së qytetit ku përfshihen: rrugë, trotuare, rrjeti i kanalizimeve, etj.

Evidenton projekte me emergjente në forcimin e pjesëmarrjes së qytetareve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve publike.

Siguron bashkëpunim me përfaqësues të biznesit, forumet dhe përfaqësuesit komunitarë lokalë për identifikimin e partnerëve lokalë pjesëmarrës në zbatimin e projekteve.

Projekton dhe bën preventive të rikonstruksioneve dhe ndërtimeve të reja në infrastrukturën publike të qytetit.

Merr pjesë në çdo takim që organizon drejtoria për realizimin e objektivave të punës së drejtorive por edhe për objektivat e drejtorive të tjera me qëllim koordinimin e punëve midis tyre.

Realizon inventarizimin e rrjetit rrugor të bashkisë dhe të gjendjes së tij me metoda grafike.

Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara nga Drejtoria, duke sqaruar dhe dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit.

Përpilon analizën e çmimeve të preventivave të objekteve të projektuara.

Ndjek detyrat e ngarkuara nga eprori dhe raporton për çdo problem që del gjatë punës.

## • **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist Urbanist:**

Administron regjistrin e Planifikimit të Territorit.

Boton në regjistër:

Studimin e hartuar për të përcaktuar faktet dhe analizuar problemet për Instrumentin Vendor të Planifikimit

Vendimin e Keshillit Bashkiak për fillimin e procesit të hartimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit

Vendimin e Keshillit Bashkiak për pezullimin e procesit të hartimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit

Vendimin e Keshillit Bashkiak për hartimin e Instrumentit Vendor të Planifikimit së bashku me planin e veprimeve, i cili dergohet AKPT brenda 15 ditëve nga miratimi

Rekomandimet e AKPT për përmirësimin e planit të veprimeve

Projektin përfundimtar të Instrumentit Vendor të Planifikimit

Vendimin e Keshillit Bashkiak për miratimin e Instrumentit Vendor të Planifikimit.

Studimin e autoritetit që përcakton faktet dhe formulon qëllimin e interesit publik për instrumentat e vecanta të kontrollit të zhvillimit për të drejtën e servitutit, rezervimit dhe të lenies, që nuk janë miratuar si pjesë e planit.

Vendimin për zbatimin e instrumentit të vecantë të kontrollit të zhvillimit.

Vendimet për miratimin e servitutit publik, rezervimit publik të tokës dhe të drejtës së preferimit.

Dokumentacionin për paraqitjen e kërkesave për zhvillim, leje ndertimi, leje infrastrukture, leje përdorimi, leje përdorimi infrastrukture, akte kontrolli për realizimin e punimeve, kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

Vendimin për miratimin ose refuzimin e kërkesës për zhvillim leje ndertimi, leje infrastrukture, leje përdorimi, leje përdorimi infrastrukture, akte kontrolli për realizimin e punimeve, kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

Lejen e zhvillimit, leje ndertimi, leje infrastrukture, leje përdorimi, leje përdorimi infrastrukture, akte kontrolli për realizimin e punimeve, kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

Është përgjegjës për administrimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS)

GIS është një sistem i kompjuterizuar i regjistrimit të informacionit i bazuar në një hartë dixhitale, për mbledhjen, përditesimin, ndryshimin, ruajtjen, përpunimin, depozitimin, kërkimin dhe rigjetjen e këtij informacioni për objekte gjeografike, karakteristikat e tyre dhe të dhëna të tjera për token, me

qellim dhenien e zgjidhjeve ndervepruese ose vendimmarrese ndihmuese per detyrat e projektimit, modelimit, analizes, kerkimit, menaxhimit dhe objektivave te tjere ne nje hapesine gjeografike.

## **I-Lëvizja paralele**

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:**

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) te zoteroje nje Diplomë “Bachelor” në Arkitektur, Inxhinieri Ndërtimi, Gjeodezi, Planifikim dhe Menaxhim Urban, Inxhinieri Elektrike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e drejtoris së Burimeve Njëzëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të një vleresimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Satatusit të nëpunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.

- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjendjes shëndetsore;

***Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 20.08.2020.***

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **21.08.2020**, Drejtoria e Burimeve Njërëzore në Bashkisë Patos do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njërëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njërëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite mbi Ligjin Nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet neligjore dale ne zbatim te tij;
- b. Njohurite mbi Ligjin Nr.9131, date 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- c. Njohurite mbi Ligjin Nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”
- d. Njohuritë mbi ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- e. Ligji nr.8402 dt10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
- f. VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”
- g. Vendimi nr.1 dt.30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e zhvillimit të teritorrit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”
- h. Vkm nr.283 dt.01.04.2015 “Për objektet bujqësore blegtorale”.

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

**Totali i pikëve është 100 pikë.**

## 1.6

### DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vendin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

#### 2- Pranimi në Shërbimin Civil

*Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.*

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.*

## 2.1

### KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:**

- a. Te jete shtetas shqiptar;
- b. Te kete zotesi te plote per te vepruar;
- c. Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;
- d. Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;
- e. Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) te zoteroje nje Diplomë “Bachelor” në Arkitektur, Inxhinieri Ndërtimi, Gjeodezi, Planifikim dhe Menaxhim Urban, Inxhinier Elektrik. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

*Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 25.08.2020.*

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **26.08.2020**, Drejtoria e Burimeve Njëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit te publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njëzore dhe Legjislacionit të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite mbi Ligjin Nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet neligjore dale ne zbatim te tij;
- b. Njohurite mbi Ligjin Nr.9131, date 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- c. Njohurite mbi Ligjin Nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”
- d. Njohuritë mbi ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- e. Ligji nr.8402 dt10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
- f. VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”
- g. Vendimi nr.1 dt.30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e zhvillimit të teritorrit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”
- h. Vkm nr.283 dt.01.04.2015 “Për objektet bujqësore blegtorale”.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

## **2.6 DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Konkurimi do të kryhet më datë 16.09.2020 në Sallën e Këshillit të Bashkisë ora 09<sup>00</sup>.

Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë në dt.17.09.2020, njofton listen e fituesve, Drejtorisë Burimeve Njërëzore.

Drejtoria e Burimeve Njërëzore në dt.18.09.2020, shpall listen e fituesve.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Për sqarime të metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Patos, lagja “Naftëtari”

**Drejtoria e Burimeve Njërëzore**

**Bashkia Patos**